



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:163564
Datë: 24.02.2025
Numri i dokumentit: 06890935

C.A.nr.9912/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj kryetare e kolegjit, Arsim Hamzaj dhe Liridon Maloku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditëses A.K. nga P., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat A.H. nga P., kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson e autorizuar V.I.Xh., me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurës të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2494/23, të datës 30.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.02.2025 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Prizrenit –Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2494/23, i datës 30.01.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.2494/23, të datës 30.01.2024, ka vendosur si në vijim: *“I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.K. nga Prizreni, DETYROHET e paditura Komuna e Prizreni – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses të kompensohet në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë: 1.Për periudhën kohore Maj - Nëntor 2022, në shumën prej 273.68 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (31.07.2023), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit. II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses të ia paguaj shumën prej 124 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.”*

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur e paditura për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që

Gjykata e Apelit, ankesën ta aprovojë si të bazuar, ashtu që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të priset dhe të hedhet poshtë padia, apo të ndryshohet aktgjykimi ose të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim ose rivendosje.

Përgjigje në ankesën nuk pati.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit, me datë 31.07.2023 në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, me të cilën ka kërkuar shpërblimin e inflacionit në pagë, me arsyet sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të te gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.2494/23 të datës 30.01.2024, , me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga Kontrata e punës për paditësen e lëshuar nga Komuna e Prizreni – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura në Institucionin parashkollor “Zambaku” në Prizren, si mësimdhënëse. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2022 vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditëses e që është shuma prej 393.22 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së. Gjykata u bazua në dispozitat e nenit 35, par.10, të Kontratës Kolektive mbi Arsimin e lidhur me datë 22.01.2021, me të cilën parashihet se: *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve.”* Lidhur me kamatën gjykata u mbështet besimin në nenin 382 par1 dhe par.2 të LMD-së, si dhe në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës u mbështet në nenin 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi

2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika o) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka gjykuar brenda kufijve të kërkesëpadisë së paditëses dhe nuk ka bërë tejkalim të kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit po ashtu vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që Gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, duke i vërtetuar të gjitha faktet me rëndësi që kanë qar në aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjykuar për kompensimin e inflacionit në pagë, për arsye se: Me nenin 90 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *”Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet : a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) në nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 5 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*.

Me nenin 35 paragrafi 10, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021 përcaktohet se: *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*. Ndërsa Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 në pikën II parashih që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve.”*

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditëses në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”.

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk janë përmbushur kushtet e parapara të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruesit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, përfshirë të drejtën për kompensim të ushqimit, i takon pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë këtu e paditura.

Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditëses, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë, ndërsa në nenin 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, ndër të tjera thuhet se: “*Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat - DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës...*”, ndaj detyrimi për zbatimin e kësaj kontrate ka fuqinë ligjore.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së dhe llogaritja është bërë saktë në përputhje me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me kamatën.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Janë vlerësuar pretendimet ankimore të të paditurës, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

C.A.nr.9912/2024, me datë 20.02.2025

Kryetarja e kolegjit
Hidajete Gashi Alaj, d.v.

Numri i lëndës: 2023:163564
Datë: 24.02.2025
Numri i dokumentit: 06890935